



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 228/14 prot.,

Datë 24.03.2026

V E N D I M

Nr. 417/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.307/2026, datë 25.02.2026, dhe Nr. 368/2026, datë 09.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK me NIPT J61828068L dhe adresë Rruga 5 Maji, Nd. 82, Hyrja 7, Tiranë.
- BOE “MALBERTEX shpk” me NIPT K71821009N dhe adresë Tirane Tirane Tirane, TIRANE, SIRI KODRA BLL.MAGAZINAVE, Tiranë & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”.
- Autoriteti Kontraktor:** ILLYRIAN GUARD SH.A. me adresë Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë 1016
- Subjekt i interesuar:** OE “Vojsava Zeneli” P.F., NUIS L12330004A, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 2, kati i dytë, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.307/2026, ku vendosi:

- 1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, me nr. 264/2026 protokollin, datë 28.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6288, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.*
- 2. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk me nr. 228/2026 protokollin, datë 26.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6277, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.*
- 3. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk me nr. 252/2026 protokollin, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.*
- 4. Autoriteti kontraktor të ri-vlerësojë BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, sipas konstatimeve në këtë vendim.*
- 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk për ankesën me nr. 252/2026 protokollin, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6282.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 69/32 prot., datë 02.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 228/6 prot., datë 03.03.2026, autoriteti kontraktor ILLYRIAN GUARD SH.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 307/2026, datë 25.02.2026.

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 69/30 prot., datë 27.02.2026;

I.3. Në datë 09.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.368/2026, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet referuar vendimit të KPP-së Nr.307/2026, datë 25.02.2026.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën përcjellëse me nr. 69/36 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 228/11 prot., datë 18.03.2026, autoriteti kontraktor ILLYRIAN GUARD SH.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 307/2026, datë 25.02.2026 dhe Nr. 368/2026 datë 09.03.2026.

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 69/34 prot., datë 12.03.2026;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 69/36 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 228/11 prot., datë 18.03.2026, autoriteti kontraktor ILLYRIAN GUARD SH.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 307/2026, datë 25.02.2026 dhe Nr. 368/2026 datë 09.03.2026.

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 69/34 prot., datë 12.03.2026;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 69/36 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 228/11 prot., datë 18.03.2026,, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.307/2026, datë 25.02.2026 dhe Nr. 368/2026, datë 09.03.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për BOE ankimes “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk dhe statusi i këtij BOE qëndron përsëri “I skualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalit të rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 69/34 prot., datë 12.03.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së. Gjithashtu, edhe pas ri-vlerësimit, autoriteti kontraktor nga

përlllogaritjet, e ka cilësuar ofertën e BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk si ofertë anomalisht të ulët, në përputhje me parashikimet e ligjore, dhe në përfundim të analizës, për autoritetin kontraktor **nuk është krijuar bindja** se është e rregullt me të gjithë elementët e saj, dhe **e ka skualifikuar këtë BOE**, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

